



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER

Nr. 13351/2
prot.

Fier më 03/12/2025

VENDIM

Nr. 109, datë 27/11 /2025

**“MBI STRUKTURËN, NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TË
BASHKISË FIER PËR VITIN 2026 “**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, gërma “f” e ndryshuar, të nenit 54; Ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ‘ndërtesa’, bazën e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar me VKM nr. 144, datë 13.02.2020; Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”; Ligjin nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; Ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”; Ligjin nr. 8098, datë 23.03.1996, “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar; Ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar; Ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”; Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”; Ligjin nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”; Ligjin nr. 10296, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të Ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, të nenit 31, 32 dhe 33; të Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”, konkretisht nenit 11, nenit 12, nenit 27, nenit 35, nenit 37 dhe nenit 38; të Ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; të Vendimit nr. 99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, i ndryshuar;

Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të taksës së ndërtesës në Bashkinë Fier, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjent i mbledhjes së taksave dhe tarifave” është personi i cili, sipas kërkesave të këtij vendimi, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e Bashkisë Fier apo strukturave të saj, të të ardhurave nga taksat dhe tarifat.
2. “Pasuri e paluajtshme” janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
3. “Kadastra fiskale” është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.
4. “Drejtoria e të Ardhurave Vendore”, struktura për administrimin e taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Fier.
5. “Niveli tregues i taksës” janë nivelet e taksave të parashikuara sipas këtij vendimi.
6. “Çmim vlerësues”, njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.
7. “Ndërtesë”, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në vendim.
8. “Ndërtesë e papërfunduar”, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
9. Njësi pronësore”, ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.
10. “Ndarje e njësive pronësore për banim”, pjesa e njësive pronësore që përdoret për qëllim banimi.
11. “Ndarje e njësive pronësore për veprimtari ekonomike”, pjesa e njësive pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.
12. “Përdorues”, individ, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.
13. “Taksë” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e Bashkisë Fier që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Bashkisë Fier.
14. “Tarifë” është pagesa, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejt apo nëpërmjet një agjenti tek administrata e Bashkisë Fier. Pagesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë.
15. “Taksapagues”, çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njërën nga taksat vendore të përcaktuara në këtë vendim apo legjislacionin në fuqi.
16. “Vlerë e pasurisë”, është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësive pronësore.
17. “Veprimtari ekonomike”, është çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

Të miratohet struktura dhe niveli i taksave dhe tarifave vendore, si dhe administrimi i tyre në Bashkinë Fier, si më poshtë vijon:

A. TAKSAT VENDORE

- I. **Taksa mbi pasurinë e paluajtshme** për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, në të cilën përfshihen:
 - a) *Taksa mbi ndërtesat*
 - b) *Taksa mbi tokën bujqësore*
 - c) *Taksa mbi truallin*
- II. **Taksa e fjetjes në hotel**
- III. **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja**
- IV. **Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**
- V. **Taksa vjetore e mjeteve të përdorura:**
- VI. **Taksa e tabelës**

B. TARIFAT VENDORE

- I. **Tarifa për menaxhimin e mbetjeve** për kategorinë familjare
- II. **Tarifa e shërbimit** për kategorinë familjare
- III. **Tarifa për menaxhimin e mbetjeve** për kategorinë biznes
- IV. **Tarifa e shërbimit** për kategorinë biznes
- V. **Tarifa për mjetet e transportit**
- VI. **Tarifa për dhënie leje ushtrimi aktiviteteve** në ambientet publike
- VII. **Tarifa për shërbime administrative dhe urbanistike**
- VIII. **Tarifa e zënies së hapësirës publike**
- IX. **Tarifa të ndryshme** në funksion të drejtorive dhe ndërmarrjeve vartëse
- X. **Tarifa për dhënie/marrje me qira të pronave të Bashkisë Fier**
 - a. **Tarifa për përdorimin e ambienteve sportive dhe kulturore** (kalçeto, fushë sporti, palestër, teatër, sallë mbledhjesh, etj.)
- XI. **Tarifa për pagesën e linjave të energjisë** për panele diellore
 - a. **Tarifa për subjektet** në bazë të fuqisë së instaluar për panele me funksion fitimprurës, jo për qëllime individuale
- XII. **Tarifa për shërbimin e varrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave publike**
- XIII. **Tarifa për parkimin nëntokësor dhe parkimin pranë terminalit të autobusëve**

I. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, në përpjesëtim me pjesën që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e zotërimit të të drejtës së pronësisë.

NË TAKSAT MBI PASURINË E PALUAJTSHME PËRFSHIHEN:

- a) Taksa mbi ndërtesën
- b) Taksa mbi tokën bijqësore
- c) Taksa mbi truallin

TAKSA MBI NDËRTESET

- Taksa mbi ndërtesën zbatohet në përputhje me parashikimet dhe përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 132, datë 07.03.2018, “Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit, të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve e rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, të ndryshuar, si dhe çdo akti tjetër që normon këtë proces.
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohet ndryshe.
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen gjithashtu zhvilluesit të cilët nuk arrijnë të përfundojnë ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati për llogaritjen e taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
- Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme – ndërtesë, llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj ose për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi në Bashkinë Fier është **53.100 lekë/m²**.

- a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë.
- b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
- c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbolli, basketbolli, volejboli, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

- d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshirë ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas qyteteve.
- Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdoniveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.
- e) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtar mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat

1. Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është:
 - a. 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
 - b. 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
 - c. 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
3. Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës, të përcaktuar në aktin e lejes së ndërtimit apo aktin e regjistrimit pranë regjistrave të pasurive të paluajtshme:
 - a. Apartamente banimi do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim”.
 - b. Njësi biznesi do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike”.
 - c. Bodrum/parking i mbuluar do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret për parkim të mbuluar dhe bodrume”.
4. Kur nga verifikimi në terren rezulton se ndërtesa apo njësi të veçanta të saj janë vënë në përdorim/shfrytëzim, pavarësisht se ndërtesa në tërësi nuk ka përfunduar, taksa llogaritet e plotë për pjesën në përdorim/shfrytëzim. Në këtë rast, baza e taksueshme llogaritet me kostot e ndërtimit për pjesën e papërfunduar dhe me çmimet vlerësuese për pjesët e vëna në përdorim. Për pjesë të ndërtesës të vëna në përdorim, baza e taksës do të jetë e plotë. E njëjta situatë vlen edhe kur nuk është dhënë leja e shfrytëzimit të ndërtesës apo nuk është bërë regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.
5. Sipërfaqja e prezumuar.
Për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohet për banim, identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijnë:
 - a. 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
 - b. 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuar me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.
6. Për sa i përket kategorisë, ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe/ose agjenti tatimor i caktuar nga Bashkia Fier bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.

7. Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve tregëtare, Taksa e Ndërtesës përlllogaritet dhe paguhet si “Ndërtesa për ushtrim aktiviteti me qëllim përfitimi” me sipërfaqje minimale 16 m², për atë pjesë të sipërfaqes së ndërtesës në të cilën ushtrohet veprimtaria tregëtare, përjashtohet nga kategoria “Ndërtesa Banimi”.

Tabela 1 – Niveli i taksës mbi ndërtesat

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Niveli i taksës nbi ndërtesat	
			Bashkia Fier	Njësitë Administrative
			ZONA .A	ZONA .B
1	Ndërtesa që përdoren dhe shfrytëzohen për banim	Lekë/m ² sip. shfrytëzimi	0.05%	0.04%

Baza e taksës

Baza e taksës është **sipërfaqja e ndërtimit në metra katrorë e ndërtesës** ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës, për çdo kat.

Dokumentet që vërtetojnë pronësinë janë: **Çertifikata e Pronësisë, Vërtetim Hipotekor, Leje Legalizimi, Vendim Privatizimi**, si dhe çdo dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe **deklaratën e vetëdeklarimit**.

Kategoritë e ndërtesave

Ndërtesa banimi

Në këtë kategori përfshihen:

- Të gjitha hapësirat që përdoren për qëllime jo fitimprurëse nga qytetarët, vetëm për qëllim banimi.
- Ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit që janë të pasitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi.

Ndërtesa për veprimtari ekonomike (biznes)

Në këtë kategori përfshihen:

- Ndërtesat për tregti dhe shërbime.
- Ndërtesat për shërbime tregtare, administrative dhe të ngjashme me to, si: hotele, motele, stabilimente turistike, shtëpi pritjeje, njësi turizmi familjar, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, banka, zyra, farmaci, klinika, spitale, maternitetet, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve, stadione, komplekse sportive (palestra, fitnese), pishina të hapura dhe të mbyllura, si dhe çdo njësi tjetër tregtare apo shërbimi të ngjashme me këto.

Ndërtesa për veprimtari prodhuese

Në këtë kategori përfshihen të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues, si:

- Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, letre, kartoni, plastike;

- Prodhim tullash, tjegullash, blloqesh banimi, furrash gëlqereje, produkte ushqimore, furra buke;
- Prodhim konfeksionesh, vajrash, përpunim të naftës, shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produkteve farmaceutike;
- Si dhe çdo veprimtari tjetër të ngjashme prodhuese.

Përcaktime të veçanta

- Për ato **ndërtesa banimi** që janë të regjistruara si **seli të subjekteve tregtare**, taksa e pasurisë përlllogaritët dhe paguhet sipas kategorisë “**Ndërtesa për biznes**”, (sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë) duke u përjashtuar nga kategoria “**Ndërtesa banimi**”.
- Për **ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit**, të destinuara për shitje, por që janë ende të pashitura, taksa vendoset sipas **destinacionit të përdorimit të ambientit** të ndërtesës:
 - **Apartamentet e banimit** i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “**Ndërtesa që përdoren për banim**”;
 - **Njësitë e biznesit** i nënshtrohen taksës në kategorinë “**Ndërtesa që përdoren për veprimtari ekonomike**”;
 - **Bodrumet dhe parkimet e mbuluara** i nënshtrohen taksës në kategorinë “**Ndërtesa që përdoren për parkim të mbuluar dhe bodrume**”.

Përjashtime:

Nga taksa mbi ndërtesat përjashtohen:

- **Pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore**, që përdoren për qëllime jofitimprurëse, si dhe pronat e shoqërive aksionare në të cilat aksionere është 100% Bashkia Fier;
- **Pasuritë në pronësi të shtetit**, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- **Ndërtesat e banimit** që shfrytëzohen nga qiramarrës me qira të paliberalizuara;
- **Banesat sociale** në pronësi të bashkive;
- **Pasuritë e paluajtshme – ndërtesa**, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren prej tyre si banesa sociale;
- **Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare**, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- **Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”**, sipas përcaktimeve në legjislacionin e fushës së turizmit, që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht (“brand name”);
- **Ndërtesat e banimit të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët**, të cilët përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që kanë banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistë ose persona në ngarkim të tyre që janë të paaftë për punë;
- **Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve** që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- **Ndërtesat kulturore**, që janë nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën gjatë së cilës deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Afatet e pagesës

1. Për kategorinë “Ndërtesa që përdoret për banim”

- Detyrimi vjetor do të shpërndahet për periudhën **Janar Dhjetor** dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pranë sporteleve të **Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime sh.a. Fier**.

- Për familjet që nuk kanë paraqitur dokument pronësie, **faturimi aforfe** do të bëhet për sipërfaqen **100 m²**.
- Për familjet që **nuk kanë kontratë furnizimi me ujë dhe kanalizime** me ndërmarrjen **Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Fier**, detyrimi vjetor për taksën mbi ndërtesën do të paguhet **pranë sporteleve të Njësi Administrative dhe në sportelet e Bashkisë Fier**, brenda vitit kalendarik.

2. Për kategorinë “Ndërtesa që përdoret për veprimtari ekonomike”

- Detyrimi vjetor do të paguhet brenda datës **30 Prill** të çdo viti.

Gjobat për vonesa në pagesë

Tatimpaguesi që nuk paguan detyrimin tatimor brenda afatit të përcaktuar, detyrohet të paguajë **një gjobë të barabartë me 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë**, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.

Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se **365 ditë kalendarike**.

Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse

Arkëtimi i taksës mbi ndërtesat do të kryhet nga strukturat përgjegjëse si më poshtë:

- **Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave**, për taksën e ndërtesës që aplikohet ndaj subjekteve të biznesit të vogël dhe biznesit të madh;
- **“Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime” sh.a. Fier**, për familjarët që kanë kontratë aktive me ndërmarrjen e ujësjetllës;
- **Arkat e Bashkisë Fier dhe Njësitë Administrative**, për:
 - Debitorët me detyrime të prapambetura përpara vitit 2026;
 - Familjet që nuk kanë kontratë me shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a.

Dokumentacioni që dorëzohet për të përfutuar përfshitim nga taksa e ndërtesës

Subjektet familjarë që përfshihen nga taksa e ndërtesës, depozitojnë pranë Njësisë Administrative/Lagjes ku kanë vendbanimin, dokumentacionin përkatës që vërteton se:

- a. marrin pension pleqërie/pension social;
 - b. janë kryefamiljarë që kanë në përbërje të familjes vetëm pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre të paaftë për punë;
 - c. trajtohen me ndihmë ekonomike;
 - d. kopje të dokumentit ku banojnë që provon se janë pronarë apo përdorues të pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës etj;
- kopje të kontratës/ librezës/ faturës së abonentit kryefamiljar që bën kërkesën për përfshitim.

b) TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE.

Taksa mbi tokën bujqësore është **detyrim vjetor** dhe paguhet **brenda vitit fiskal**.

Baza e taksës

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është **sipërfaqja e tokës bujqësore**, në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas **dokumenteve që vërtetojnë pronësinë**. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, **përdoruesi i tokës bujqësore** paraqet një **vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës**, pranë Bashkisë ku ndodhet prona. Pas vetëdeklarimit, **Drejtoria e Taksave**, në bashkëpunim me **njësitë administrative përkatëse**, kryen verifikimin e sipërfaqes së deklaruar.

Llogaritja e taksës

Niveli i taksës caktohet në **lekë për hektar**. Detyrimi i taksës llogaritet si **shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme**. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, janë përcaktuar si më poshtë:

Tabela 2 – Niveli i taksës mbi tokën bujqësore

Nr	Kategoria	Njësia	Vlera sipas Ligjit (Lekë/ha/vit)	Taksa 2026 (Lekë/ha/vit)
1	Kategoria I	Lekë/ha/vit	5,600	5,320
2	Kategoria II	Lekë/ha/vit	4,900	4,655
3	Kategoria III	Lekë/ha/vit	4,200	3,990
4	Kategoria IV	Lekë/ha/vit	3,600	3,420
5	Kategoria V	Lekë/ha/vit	3,000	2,850
6	Kategoria VI	Lekë/ha/vit	2,400	2,280
7	Kategoria VI-X	Lekë/ha/vit	1,800	1,710

Detyrimet e prapambetura

Për familjet që janë **debitore për taksën e tokës bujqësore**, detyrimi i prapambetur do të **paguhet sipas vlerës së plotë të taksës** përkatëse të vitit për të cilin është përcaktuar në **paketën fiskale** përkatëse.

Përfundime

- **Taksapaguesi**, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i **forcave madhore**, përjashtohet përkohësisht (deri në **1 vit**) nga pagesa e taksës për tokën bujqësore. Përfundimi dhe kohëzgjatja e tij përcaktohen nga **Drejtoria e Emergjencave Civile** dhe **Drejtoria e Bujqësisë** e Bashkisë Fier, në përpjesëtim me dëmin e shkaktuar, deri në **75% të vlerës së dëmit**.
- **Përfundohen nga taksa** tokat bujqësore që **mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari** për pesë (5) vitet e para nga momenti i mbjelljes.

Afatet e pagesës

Detyrimi për pagesën e taksës mbi tokën bujqësore është **detyrim vjetor** dhe duhet të **likuidohet brenda vitit kalendarik**.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e taksës

Llogaritja dhe arkëtimi i taksës mbi tokën bujqësore kryhen nga:

- Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave , në bashkëpunim me
- Njësitë Administrative përkatëse të Bashkisë Fier

c) TAKSA MBI TRUALLIN

Baza e taksës

Baza e taksës mbi truallin është **sipërfaqja e truallit**, në metra katrorë, në **pronësi** ose **në përdorim** të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas **dokumentacionit që e vërteton pronësinë**.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, **përdoruesi i truallit** paraqet një **vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit** në përdorim, pranë **Bashkisë Fier** ose **njësisë administrative** përkatëse ku ndodhet trualli.

Niveli i taksës

Niveli i taksës caktohet në **lekë për metër katror**. Detyrimi i taksës llogaritet si **shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme**. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori të bazës së tatueshme, janë si më poshtë:

Tabela 3 – Niveli i taksës mbi truallin

Kategoria	Vlera e taksës së truallit për qëllime, banimi (Lekë/m ² /vit)	Vlera e taksës së truallit për qëllime biznesi (Lekë/m ² /vit)
Bashkia Fier	0,56 Lekë/m ² /vit	20 Lekë/ m ² /vit

Afatet e pagesës:

Detyrimi vjetor për kategorinë “Truall për veprimtari ekonomike” do të paguhet **brenda datës 30 Prill**.

Detyrimi vjetor për kategorinë “Truall për qëllime banimi” do të paguhet **brenda vitit kalendarik**.

Gjobat për vonesë në pagesë

- Tatimpaguesi që nuk paguan detyrimin tatimor brenda afatit të përcaktuar, detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.
- Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.
- Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse

- Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave, për llogaritjen dhe arkëtimin e taksës mbi truallin për qëllime biznesi;
- Arkat e Bashkisë Fier dhe Njësitë Administrative, për llogaritjen dhe arkëtimin e taksës mbi truallin për qëllime banimi.

II. TAKSA E FJETJES NË HOTEL:

Përkufizim: Me termin “hotel” kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet **hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar**, dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Hotelet ndahen në kategori sipas Ligjit “Për Turizmin”:

- Hotele/Motele me 4–5 yje, dhe
- Motele, bujtina, fjetore, stabilimente turistike dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to.

Baza e taksës

- Baza e taksës së fjetjes në hotel është **numri i netëve të qëndrimit** në strukturën akomoduese.
- Detyrimi për taksën llogaritet si **shumëzim i nivelit të taksës** së vendosur nga Bashkia, për **çdo natë qëndrimi**, me **numrin e netëve të fjetjes** në hotel.
- Detyrimi për taksën i takon **klientit që strehohet** në hotel, ndërsa hoteli e **mbledh dhe e mban për llogari të Bashkisë**, në territorin e së cilës ndodhet objekti.
- Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të, **vlera e taksës së fjetjes**.

Tabela 4 – Niveli i taksës së fjetjes në hotel

Kategoria	Niveli i taksës
Hotel 4-5 yje	175 lekë për çdo fjetje
Hotel nën 4 yje, hotel, bujtinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas Ligjit “Për Turizmin”	70 lekë për çdo natë qëndrimi

Afatet e pagesës

- Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të Bashkisë Fier **kryhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.**
- Tatimpaguesi që nuk arrin të paguajë shumën e detyrimit tatimor brenda afatit të parashikuar, detyrohet të paguajë një **gjobë të barabartë me 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë**, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.
- Në asnjë rast, **gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.**

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e taksës

- Për arkëtimin e kësaj takse ngarkohet **Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave e Bashkisë Fier.**

III. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA:

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë

1. Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë përcaktohet sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar.
2. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet, sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.
3. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën **4% (katër për qind) deri 8% (tetë për qind)** të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si rezultat i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo biznesi. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt nga Këshilli i Ministrave.
4. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 3, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është si më poshtë:
 - a) Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë, bujqësisë, për ndërtime individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe për ndërtime për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është **1% (një për qind) deri 3% (tre për qind)** e vlerës së investimit.
 - b) Për projekte të infrastrukturës që lidhen me ndërtimin e rrugëve kombëtare, porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është **0.1% (zero pikë një për qind)** e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
 - c) Për ndërtesat që janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është **0.5% (zero pikë pesë për qind)** e vlerës së investimit.

d) Për ndërtesat që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është **0% (zero)** deri **3% (tre për qind)** të vlerës së investimit. Këshilli Bashkiak përcakton me vendim zonat malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi.

5. Detyrimi për taksën i takon investitorit.
6. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një njësie vendore ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një njësie tjetër vendore, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës njësi.

Përfshirje:

1. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese **“Hotel/Resort me pesë yje, status special”**, sipas përcaktimit në legjislacionin në fushën e turizmit, dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht (*brand name*).
2. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve që zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si **“Agroturizëm”**, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
3. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet për **rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave** të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përfshirjen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Përfshihen gjithashtu **investimet në kuadër të programeve të rindërtimit**, sipas dispozitave të ligjit për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore.

Kur objekti, sipas projektit, përfshin disa nga kategoritë e cituara në tabelë, **llogaritjet e taksës bëhen për vlerat përkatëse të secilës kategori.** Referuar tabelës 5, **zona D** i referohet taksës së ndikimit në infrastrukturë për Njësitë Administrative.

Tabela 5 — Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe zonave

Nr	Kategoritë dhe nënkategoritë	Taksa e ndikimit në infrastrukturë sipas zonave (%)			
		A	B	C	D
1	Objekte për qëllime banimi dhe shërbimi, individuale — llogaritet çmimi i shitjes për m ² × %				
	a) Objekte deri në 2 kate	2%	2%	2%	2%
	b) Objekte mbi 2 kate	3%	3%	3%	2%
	c) Objekte për qëllime shërbimi	3%	3%	3%	2%
2	Objekte për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të kryera nga shoqëri ndërtimi — llogaritet me çmimin e shitjes për m ² × %				
	a) Objekt njëkatësh	4%	4%	4%	4%

	b) Objekte 2-3 kate	5%	5%	5%	5%
	c) Objekte mbi 4 kate	6%	6%	6%	6%
	d) Objekte për qëllime shërbimi	7%	7%	7%	7%
3	Ndërtesa për prodhim dhe përpunim me funksion bujqësor e blegtoral — llogaritet me % të vlerës së investimit	1%	1%	1%	1%
4	Ndërtesa për prodhim në sektorin industrial, objekte me përdorim publik, në turizëm, fetar, bamirësie etj.	3%	3%	3%	3%
5	Rikonstrukcion me ndryshim funksioni nga banesë në njësi shërbimi — % × vlera e investimit	3%	3%	3%	3%
6	Rikonstrukcion me ndryshim funksioni nga njësi shërbimi në banesë — % × vlera e investimit	3%	3%	3%	3%
7	Mur rrethues (sipas vlerës së investimit)	1%	1%	1%	1%
8	Rikonstrukcion objekti (llogaritet sipas preventivit)	3%	2%	2%	2%
9	Vendosje antenash (konstrukcione metalike)	3%	3%	3%	3%
10	Struktura për qëllime publike dhe institucione shtetërore (përjashtohet Bashkia Fier)	3%	3%	3%	3%
11	Projekte infrastrukturore, përfshirë makineri (linja elektrike, rrugë, tunele, ujësjellës, kanalizime etj.) — llogaritet sipas preventivit	0,1%	0,1%	0,1%	0,1%
12	Ndërtesat në proces legalizimi (sipas vlerës së investimit)	0,5%	0,5%	0,5%	0,5%

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse

Llogaritja e taksës dhe dokumentimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë kryhen nga **Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Transportit Publik, Sistemit të Adresave dhe Sinjalistikës Rrugore**, si dhe nga **Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave**.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat në proces legalizimi kryhet nga **Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave**, ndërsa **arkëtimi** realizohet nga po e njëjta drejtori.

IV. TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Dispozita të përgjithshme

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe për të gjitha pasuritë e paluajtshme në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, **para kryerjes së regjistrimit**, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës

Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është **sipërfaqja e ndërtimit**, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në **lekë për metër katror** të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e saj.

Baza e taksës për pasuritë e tjera të paluajtshme

Baza e taksës është **vlera e shitjes së pasurisë**, ndërsa niveli i taksës caktohet në përqindje. **Niveli tregues i taksës është 2%**. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e saj.

Tabela 6 — Niveli i taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë

Nr.		Niveli i taksës
1.	Ndërtesa banimi	300 lekë/ m ²
2.	Ndërtesa për tregti e shërbime, përfshirë zyrat	700 lekë/ m ²
3.	Ndërtesa të tjera	500 lekë/ m ²

Përjashtime

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse:

- Enti Kombëtar i Banesave,
 - Ministria e Financave,
 - Organet e qeverisjes qendrore dhe vendore.
 - **Personat që janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.**
- Subjektet që **dhurojnë pasuri të paluajtshme**, kur përfitues janë:
- institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore ose vendore;
 - bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me pjesën e veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi.
 - Në këto raste, dhuruesi, pasi merr vërtetimin nga Këshilli Bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së dhuruar dhe paguan vetëm pjesën që i takon **agjentit të taksave**.
- Në rastet kur provohet simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, **zbatohet taksa sa dyfishi i vlerës**, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera ligjore.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse

Vjelja e taksës bëhet nga **Agjencia Shtetërore e Kadastrës**, e cila, në rolin e agentit të taksave:

- përfiton **3% të shumës së arkëtuar**, dhe
- derdh diferencën në llogarinë e buxhetit të Bashkisë përkatëse, jo më vonë se **data 30 e muajit pasardhës**.

- Struktura e ngarkuar për përgatitjen e Akt Rakordimit me ASHK për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Drejtoria e Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë Fier.

V. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, neni 3, “Llojet e taksave kombëtare” pika 3 “Taksa e mjeteve të përdorura të transportit” dhe pika 11 11. “Taksë regjistrimi fillestar dhe taksë e përvitshme për automjetet luksoze” të cilat në zbatim të nenit 4 “Niveli i taksave kombëtare”

pika 3 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit.

Pika 11 “Pavarësisht nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbi makinat luksoze zbatohet taksë regjistrimi në masën 70 000 lekë për regjistrim të çdo makine luksoze dhe taksë e përvitshme në masën 21 000 lekë çdo vit.

Taksa e përvitshme për automjetet luksoze është e vlefshme për 365 ditë. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoritë Rajonale, në momentin e vjeljes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit”

Taksa llogaritet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 18, datë 23.08.2011.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve sipas njësive të qeverisjes vendore, bazuar në vendbanimin e taksapaguesit.

Nga totali i të ardhurave mujore të arkëtuara:

- DRSHTRR mban komision 5%,
- Derdh 18% të të ardhurave në llogarinë e thesarit të njësisë së qeverisjes vendore.

Rakordimi i pagesës bëhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve, sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të Ministrit të Financave.

- Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse
- **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR)** është agjent tatimor për mbledhjen dhe derdhjen e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, brenda datës 30 të çdo muaji.

VI. TAKSA E TABELËS:

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo edhe për të tretët. Këto tabela vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike apo private.
2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, tabelat kategorizohen në:
3. i) **Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit**, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në këto tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet si e tillë.

ii) **Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit** ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

iii) **Tabelë për qëllime reklamimi**, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private — si në tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj. Këto tabela kanë përmbajtje reklamimi për vetë subjektin ose për të tretët dhe shërbejnë si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

iv) **Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairove, spektakleve, stendave reklamuese, banderolave etj.**

4. Taksa e tabelës është **taksë vjetore**. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairove, spektakleve, stendave reklamuese, banderolave etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
5. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit ose që shërbejnë për qëllime orientimi, reklamimi ose ekspozimi.

Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben **sipërfaqja në metra katrorë** që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga gërma të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese (si mur, fasadë e jashtme, shtyllë, kolonë apo të ngjashme me to), dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtypur apo e pikturuar, baza e vlerësimit për llogaritjen e taksës është sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.

Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe gërma, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një ose më shumë produkteve apo shërbimeve që ofrohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, ajo vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori. Në të kundërt, tabela vlerësohet si **tabelë reklamimi** dhe taksa llogaritet për këtë kategori table.

Në rastin e përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një table identifikuese, përveç atyre orientuese, si tabelë identifikuese vlerësohet vetëm ajo që është e trupëzuar (ose jo) në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose ajo që ndodhet më pranë njësisë. do tabelë tjetër konsiderohet si **tabelë për qëllime reklamimi**, dhe taksa llogaritet e paguhet për këtë kategori.

6. Nivelet e taksës së tabelës, sipas kategorizimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, jepen në **Aneksin 7**, bashkëlidhur këtij ligji.
7. **Këshilli Bashkiak** është autoriteti që vendos nivelin e bazës së taksës për çdo kategori të tabelës të dhënë në Aneksin 7, si dhe miraton procedurën e mbledhjes së kësaj takse.
8. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairëve, spektakleve, stendave reklamuese, banderolave etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Përjashtime

- Përjashtohen nga pagesa e taksës së tabelës **subjektet me statusin e “Ambulantit”**.

Tabela 7 — Nivelet e taksës së tabelës

Nr.	Emërtimi	Njësia	Niveli i taksës
I Taksë table për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoren për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit).			
1	Deri në 2 m²	Lekë/m ² /vit	0
2	Mbi 2 m² deri në 10 m²		
	a) E thjeshtë pa ndriçim	Lekë/m ² /vit	10,000
	b) Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	15,000
	c) Elektronike	Lekë/m ² /vit	20,000
3	Mbi 10 m² deri 20 m²		
	a) E thjeshtë pa ndriçim	Lekë/m ² /vit	8,500
	b) Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	12,750
	c) Elektronike	Lekë/m ² /vit	17,000
4	Mbi 20m² deri 40 m²		
	a) E thjeshtë pa ndriçim	Lekë/m ² /vit	5,500
	b) Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	8,250
	c) Elektronike	Lekë/m ² /vit	11,000
5	Mbi 40 m²		
	a) E thjeshtë pa ndriçim	Lekë/m ² /vit	4,000
	b) Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	6,000
	c) Elektronike	Lekë/m ² /vit	8,000
II	Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet biznesi, në formën dhe përmasat e tabelave për orientim (tabelë orientuese)		
	Tabela identifikuese	Lekë/m ² /vit	120
III	Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, me sipërfaqe deri në 35 m².		
	a) E thjeshtë pa ndriçim	Lekë/m ² /vit	22,500
	c) Elektronike	Lekë/m ² /vit	45,000

IV	Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairove, spektakleve, stendave reklamuese, banderolave etj.		
	Të gjitha llojet dhe përmasat	Lekë/ m ² /ditë	1,000

Afatet e pagesës:

- Tatimpaguesi që nuk paguan brenda afatit të përcaktuar (30 Prill) detyrohet të paguajë gjobë 0.06% të shumës së papaguar për çdo ditë vonese, por jo më shumë se për 365 ditë kalendarike.

Përfshirje

- Përfshihen nga pagesa e taksës së tabelës **subjektet me statusin e Ambulantit.**

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse

Ngarkohet **Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave** me:

- matjet,
- llogaritjet,
- dhe arkëtimin e kësaj takse

TARIFAT VENDORF

I. TARIFAT E SHËRBIMIT PËR KOMUNITETIN

Nisur nga ndryshimet e fundit në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane, kostifikimit të shpenzimeve dhe raportimit, lind nevoja për ndarjen e tarifës së shërbimit të aplikuar ndër vite dhe përcaktimin e fondeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Për këtë arsye, Bashkia Fier ka planifikuar që në tarifat e shërbimit për komunitetin të përfshihen këto tarifa:

I.1 Tarifa e menaxhimit të mbetjeve, kategoria familjarë

I.2 Tarifa e shërbimit

a) Rregulla të përgjithshme

1. Tarifat paguhen nga çdo familje e regjistruar në regjistrin e Gjendjes Civile. Detyrimi është vjetor dhe paguhet për vitin kalendarik.
2. Për çdo familje të re të regjistruar gjatë vitit, detyrimi arkëtohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e regjistrimit dhe llogaritet nga muaji përkatës i regjistrimit. Arkëtimi kryhet pranë arkave të Bashkisë Fier dhe Njësi Administrative, së bashku me detyrimet e tjera në momentin e regjistrimit.
3. Për familjet që kanë kontratë me shoqërinë **“Ujësjellës-Kanalizime” sh.a. Fier**, tarifat arkëtohen të ndara në 12 këste mujore.

4. Për familjet që **nuk kanë kontratë** me ndërmarrjen **Ujës-jellës-Kanalizime**, tarifat arkëtohen pranë Bashkisë Fier dhe Njësive Administrative, së bashku me taksat dhe tarifat e tjera vendore.
5. Familjarët pajisen me **certifikatë arkëtimi** (formular zyrtar) për pagesën e taksave dhe tarifave.
6. Nga pagesa përjashtohen familjet emigrante, të cilat e vërtetojnë mungesën e qëndrimit në Shqipëri për një periudhë më të gjatë se një (1) vit pa ndërprerje, me dokumentacion të vlefshëm.

Tabela 8 – Tarifat e shërbimit për komunitetin

Nr.	Emërtimi	Qyteti (Lekë/familje)	Njësiti Administrative (Lekë/familje)
1	Tarifa e manxhimit të mbetjeve	2,200	2,400
2	Tarifa Shërbimit	1,800	600

Përjashtime nga pagesa e tarifës

Përjashtohen nga pagesa e **tarifës së menaxhimit të mbetjeve** dhe **tarifës së shërbimit** këto kategori familjesh:

- Kategoritë e përjashtuara nga pagesa e tarifës së pastrimit, ku përfshihen, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbrit, të sëmurët tetraplegjik dhe paraplegjikë, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuar sipas përkufizimit të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Për të përfituar nga ky përjashtim, individët duhet të dorëzojnë pranë zyrave të Njësive Administrative, dëshminë e gjendjes së tyre:
 - a. dokumentin që vërteton kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në certifikatën familjare, si dhe persona të tjerë madhorë të paaftë për punë (invalidë ose fëmijë nën 25 vjeç që ndjekin studimet);
 - b. librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës e të luftës, statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit, vërtetimin e KMCAP, vërtetimin nga Njësia Administrative për përfituesit e ndihmës ekonomike.
- Taksapaguesit, pasuria e të cilëve është **dëmtuar nga veprimi i forcave madhore**, sipas verifikimeve të Drejtorisë së Emergjencave Civile për vit fiskal

II. TARIFA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE – KATEGORIA BIZNES

Nisur nga ndryshimet e fundit në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane, kostifikimit të shpenzimeve dhe raportimit, lind nevoja për ndarjen e tarifës së shërbimit të aplikuar ndër vite dhe përcaktimin e fondeve të nevojshme për garantimin e këtij shërbimi. Për këtë arsye, Bashkia Fier ka planifikuar që në tarifat e shërbimit për biznesin të përfshihen tarifat e mëposhtme:

Tarifa e menaxhimit të mbetjeve – kategoria biznes

1. Niveli i tarifave është **detyrim vjetor**, i cili llogaritet për **vitin kalendarik**.

- Kur një biznes krijohet ose mbyllet gjatë vitit, detyrimi do të llogaritet proporcionalisht, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) deri në datën e mbylljes.
- Kur aktiviteti mbyllet, pagesa llogaritet dhe arkëtohet në përpjesëtim me periudhën e funksionimit të biznesit gjatë vitit.
- Tatimpaguesi ka detyrimin të regjistrojë në zyrën e taksave të Bashkisë Fier çdo vendndodhje të aktivitetit të deklaruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Nëse i njëjti tatimpagues ushtron veprimtari në **territore jashtë juridiksionit të Bashkisë Fier**, ai duhet t'i regjistrojë të gjitha vendndodhjet përkatëse në zyrat e taksave të njësive përkatëse ku zhvillon aktivitetin.
- Në rast mospërputhjeje midis të dhënave të QKB-së dhe regjistrimeve lokale, **zyrat e taksave të Bashkisë** janë të autorizuar të kërkojnë përditësimin e të dhënave të biznesit, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

Tabela 9 – Tarifa e Menaxhimit të Mbetjeve, Kategoria Biznes

Nr	Kategoritë e Biznesit	Biznese me xhiro 0–14 milion lekë		Biznese me xhiro mbi 14 milion lekë	
		Qytet	Njësi Admin.	Qytet	Njësi Admin.
		Tarifa	Tarifa	Tarifa	Tarifa
I	PËR ÇDO NJËSI TREGTIMI				
1	Për tregtim (bulmet, mish, peshk, fruta, perime, etj.)	11,000	6,000	45,000	23,000
2	Artikuj industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, të tjera të ngjashme etj.)	11,000	6,000	45,000	30,000
3	Restorante, bar-bufe, kafene, piceri, fast food, të tjera të ngjashme.	11,000	6,000	55,000	48,000
4	Byrektore	5,000	3,000	20,000	11,000
5	Njësi tregtimi karburante, gaz, lëndë djegëse	25,000	20,000	100,000	95,000
6	Njësi tregtimi Materiale ndërtimi (pllaka, hidrosanitare, çimento, tulla, të tjera të ngjashme.)	20,000	15,000	70,000	70,000
7	Njësi tregtimi mobilje, elektroshtëpiake, ndriçues, materiale elektrike të tjera të ngjashme	20,000	15,000	55,000	40,000
8	Njësi tregtimi pjesë këmbimi	20,000	15,000	70,000	45,000
9	Njësi tregtimi shitje makinash	20,000	15,000	45,000	40,000
10	Magazina, dyqane që realizojnë shitje me shumicë(Njësi tregtimi me shumicë),supermarkete, tregje private, aktivitet import- eksport				
	a) deri 100m ²	20,000	17,000	60,000	45,000
	b) 101–500 m ²	40,000	25,000	75,000	65,000
	b) 501–1000 m ²	55,000	30,000	80,000	70,000
	c) Mbi 1000 m ²	80,000	35,000	130,000	100,000

11	Të tjera njësi tregtimi	15,000	12,000	35,000	30,000
II PËR ÇDO NJËSI SHËRBIMI					
1	Riparime elektro-shtëpiake, rrobaqepësi, berber, marangoz, këpuca	4,000	3,000	22,000	18,000
2	Servis celularësh, kasa fiskale	15,000	12,000	47,000	40,000
3	Punime betoni, skelë, pllaka, prerje xhami, etj.	15,000	9,000	42,000	30,000
4	Rimbushje elektronike, pagesa energjie, ujësjellësi, etj.	18,000	11,000	35,000	28,000
5	Dhënie makinash me qera	13,000	11,000	40,000	38,000
6	Servis automjetesh	20,000	20,000	75,000	50,000
7	Agjenci këmbimi valutor, agjenci turistike, agjenci transporti, agjenci doganore, kompani sigurimesh, polici private, pastrim kimik, salla lojërash (aerobik, gjimnastikë, palestër), studio	20,000	13,000	43,000	43,000
8	Kambist	13,000	11,000	30,000	28,000
9	Salla lojërash për fëmijë, kompjuter	10,000	6,000	30,000	20,000
10	Shkollë parukerie, estetist	25,000	15,000	60,000	45,000
11	Sallon bukurie	20,000	15,000	45,000	40,000
12	Parukeri, floktore	15,000	9,000	23,000	16,000
13	Institucione arsimore jopublike (shkolla, kopshte, çerdhe)	25,000	15,000	60,000	45,000
14	Kurse profesionale, gjuhë të huaja, autoshkolla, etj.	25,000	15,000	60,000	50,000
15	Shërbime në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbime në laboratorë diagnostifikimi.	45,000	35,000	70,000	55,000
16	Shërbime funerale	40,000	25,000	65,000	45,000
	Depo farmaceutike	40,000		90,000	
	Farmacit veterinarë / bujqësorë	20,000	25,000	40,000	45,000
19	Farmacit, farmacist i cili ushtron aktivitet privat	30,000	20,000	45,000	30,000
20	Hotele, motele dhe struktura akomoduese				
	a. Hotele, motele me 4 , 5 yje	40,000	40,000	70,000	60,000
	b. Hotele/motele nën 4 , yje	30,000	20,000	40,000	50,000

21	Parking privat, lavazh	20,000	8,000	30,000	15,000
22	Njësi të tjera njësi shërbimi të cilat nuk përmenden më lart	15,000	13,000	35,000	30,000
23	Ndërmarrjet (ShA apo SHPK) të shërbimit për energji elektrike e telefonisë, internet, kabllor, postë, Ujësjetllës	100,000			
24	Institucione shtetërore	85,000			
25	Shërbimi spitalor, diagnostikimi, Shtetëror apo privat	200,000			
26	Banka, filiale bankash,	150,000			
27	Agjensi financiare, filiale agjensish,	75,000			
28	Televizione private,	25,000			
29	Radio	2,000			
30	Shoqata jofitimprurëse, Fondacione, organizata joqeveritare	2,000			
31	Ambulantë	3,000			
III	PËRÇDONJËSI PRODHIMI				
1	Prodhime ushqimore buka, ëmbëlsira, bulmeti, pije etj	20,000	18,000	70,000	60,000
2	Prodhim konfeksione, veshje, këpucë, etj	36,000	30,000	120,000	100,000
3	Njësi prodhimi dhe tregtie	38,000	27,000	80,000	60,000
4	Komplekse për rritjen dhe mbarështimin e kafshëve dhe shpendëve me sipërfaqe deri në 2,000m ²	100,000			
	Me sipërfaqe nga 2,000m ² – 4,000m ²	150,000			
	Me sipërfaqe mbi 4,000m ²	250,000			
5	Komplekse blegtorale me aktivitet therje	250,000			
6	Përpunim metalesh, druri, letre, plastmasi, duralumini, kartoni etj	100,000			
7	Prodhim materiale ndërtimi, tulla, tjegulla, çimento, furra gëlqere, tombino, pllaka trotuari, bordura etj,	90,000			
8	Prodhim energji elektrike, nga burime të rinovueshme, kur nuk ka filluar aktiviteti I prodhimit	10,000			
9	Nxjerrja përpunimi dhe prodhimi i rërës bituminoze, prodhime asfalt-bctoni,	120,000			
10	Aktivitet peshkimi	20,000	15,000	60,000	50,000

11	Prodhim dhe kultivim bimesh dhe fidanesh, pemesh, dru frutorë	20,000	30,000	50,000	60,000
12	Fabrika e përpunimit të ullirit; Fabrikë vaji	120,000			
IV PROFESIONE TË LIRA					
1	Avokat, noter, përkthyes, mjek, mjek laborant, stomatolog, ekspert kontabël, mësues, veteriner, inxhinier, arkitekt projektues, agjent sigurimesh, ofrues shërbimesh për konsulencë në industrinë e naftës dhe profesione të tjera të lira, të cilat ushtrohen në ambiente të ndryshme, si dhe në	25,000	20,000	55,000	40,000
2	Biznesi i madh me aktivitet ndërtimi	60,000	50,000	100,000	90,000
3	Për çdo kantier, me leje ndërtimi- zhvillimi dhe vlerën e tij deri 1,000,000 Lekë	10,000			
	1,000,001 - 2,000,000 Lekë	15,000			
	2,000,001 -3,000,000 Lekë	20,000			
	3,000,001 - 4,000,000 Lekë	25,000			
	4,000,001 - 5,000,000 Lekë	30,000			
	5,000,001 – 15,000,000 Lekë	40,000			
	15,000,001 - 30,000,000 Lekë	80,000			
	30,000,001 - 50,000,000 Lekë	100,000			
	50,000,001 - 100,000,000 Lekë	200,000			
	100,000,001 - 500,000,000 Lekë	350,000			
	mbi 500,000,000 Lekë	700,000			
4	Biznes me aktivitet Nxjerrje dhe përpunim Hidrokarbure				
	a) Biznes nxjerrje hidrokarburesh me prodhim deri 100,000 ton	20,000,000			
	b) Biznes nxjerrje hidrokarburesh me prodhim 100,000 -400,000 ton	30,000,000			
	c) Biznes nxjerrje hidrokarburesh me prodhim mbi 400,000 ton	35,000,000			
	d)biznes përpunim hidrokarburesh me seli dhe filial brenda Bashkisë Fier	10,000,000			
	Subjekte që zhvillojnë aktivitetin Brenda bashkisë me ndikim në mjedis si kariere guri, shfrytëzim argjilash etje të ngjashme zhavorre, fraksione, larje inertesh etj të ngjashme	300,000			
5	Subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e prodhimit të energjisë diellore me aktivitet firmprurës dhe jo me karakter individual në bazë të lejes për zhvillim aktiviteti (1MËh = 50,000 leke)	50,000 Lekë/MËh			

III. TARIFA E SHËRBIMIT PËR BIZNESIN

- Për çdo biznes që ushtron aktivitetin në 4 Rajonet e Qytetit
5,000 Lekë/vit
- Për çdo biznes që ushtron aktivitetin në Njësitë Administrative në Qytet
2,000 Lekë/vit
- Për çdo tregëtar ambulant 2,000 Lekë/vit

Detyrimi për tarifat

- a) Tarifat janë **detyrim vjetor** dhe llogariten për **vitin kalendarik**,
- b) Nëse një biznes **hapet ose mbyllet gjatë vitit**, detyrimi llogaritet **nga data e regjistrimit/çregjistrimit** në Qendrën Kombëtare të Biznesit,
- c) Në rast **mbylljeje të aktivitetit**, pagesa bëhet në **përpjesëtim me kohën e funksionimit**,
 - Zbritja për ndërprerje të **përkohshme** bëhet mbi vlerën e pagesës së 3-mujorit vijues,
 - Kërkohet **procesverbal nga Sektori i Inspektimit** në Drejtorinë e Taksave dhe dokumente që provojnë mbylljen e aktivitetit,

Regjistrimi i vendndodhjeve

- Tatimpaguesi duhet të regjistrojë **çdo vendndodhje të biznesit** në zyrën e taksave të bashkisë ku ndodhet,
- Nëse ka biznese në **bashki të tjera**, duhet t'i regjistrojë **të gjitha vendndodhjet** në zyrën përkatëse të secilës bashki,

Përjashtime nga tarifat

- **Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor** përjashtohen për **5 vitet e para** të veprimtarisë,
 - E humbin këtë të drejtë nëse **bashkohen me shoqëri të tjera** që nuk janë të përjashtuara,
- **Bizneset e ngritura nga gra kryefamiljare** që kanë në ngarkim **fëmijë jetimë** përjashtohen për **2 vitet e para** të aktivitetit,

Afati i pagesës

- Afati për pagesën: deri më **30 Prill**,
- Gjobë për vonesë: 0,06% në ditë të shumës së papaguar, deri në **365 ditë**

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj tarife

- **Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave** përgjegjëse për llogaritjen, faturimin dhe arkëtimin e tarifave,
- Për **kantieret** (pika 5 e tabelës 10):
 - Tarifa llogaritet nga **Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit**,
 - dhe arkëtohet nga **Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave**,

IV. TARIFA PËR MJETET E TRANSPORTIT

- a) Tarifa e parkimit abonent
- b) Tarifa vendore e shërbimit dhe tarifa për tonazh për çdo mjet transporti për persona fizikë ose juridikë
- c) Tarifat për licencë, certifikatë dhe autorizime

a) Tarifa e parkimit abonent u jepet subjekteve fizike ose juridike vetëm pasi të pajisen me Leje për parkim abonent, e cila lëshohet nga:

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Transportit Publik, Sistemit të Adresave dhe Sinjalistikës Rrugore,

Në lejen përkatëse përcaktohen:

- Numri i vendparkimeve të miratuara;
- Vendndodhja e tyre,

Leja për vendparkim abonent duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor dhe aktet nënligjore përkatëse,

Tabela 10 – Niveli i Tarifave të Parkimit Abonent

Nr,	Kategoritë	Niveli Tarifës në Lekë	
		Tarifa vjetore (Qytet)	Tarifa vjetore (Njësi administrative)
1	Për çdo vend parkimi – autovetura 4+1 dhe 8+1	30,000	5,000
2	Për çdo vend parkimi – autobus apo kamion	40,000	10,000

b. Tarifa vendore e shërbimit dhe tarifa për tonazh për çdo mjet transporti për persona fizikë ose juridikë

Tarifa arkëtohet për çdo mjet transporti të përfshirë në inventarin e subjektit fizik ose juridik, të deklaruar në QKB për adresat parësore dhe dytësore, Afati i likuidimit është data **30 prill** e çdo viti, për të cilin llogaritet detyrimi tatimor vendor, Për çdo ditë vonesë në likuidim, llogaritet **kamatëvonesë prej 0,06%** të shumës së detyrimit të papaguar,

Tabela 11- Kategoritë e mjeteve dhe tarifat përkatëse sipas Kodit Rrugor

Nr	Kategoritë e mjeteve sipas Kodit Rrugor	Treguesit e Mjeteve		Tarifa e shërbimit për mjetet regjistruara në Bashki (deklaruar në QKB)	Tarifa e shërbimit për mjetet regjistruara në njësitë administrative
		Nr, Vende	Ngarkesa në Ton		
1,	Autoveturë	1 +4		6,000	4,000

2,	Autoveturë	1 +8		10,000	8,000
3,	Autobuza	9 - 30		13,000	95,000
4,	Autobuza	30 - 50		15,000	12,000
5,	Kamion		0-1,5	7,000	5,000
6,	Kamion		1,5 - 3,5	10,000	8,000
7,	Kamion		3,6 - 8	13,000	9,500
8,	Kamion		8,1 - 14	14,000	10,000
9,	Kamion		14,1 +	15,000	13,000
10,	Trailer		16 - 40	16,000	15,000
1, 1,	Autovinça		1 - 14	6,000	3,000
12,	Autovinça		14,1 - 100	10,000	7,000
13,	Ekskavator			10,000	8500
14,	Autobetonierë			12,000	10,000
15,	Autobotë			10,000	8,000
16,	Autobotë për transport Hidrokarburesh			15,000	15,000
17,	Autopompa betoni			12,000	12,000
18,	Fadromë me goma			10,000	9,000

Tabela 12 - Tarifat Për Liçensë/Çertifikatë/Autorizime

Nr	Emërtimi	Njësia	Tarifa
A	TARIFAT E LIÇENSIMIT TË TRANSPORTIT TË UDHËTAREVE	Vite	Lekë
1	Licencë për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit	Lekë/10 vjet	100,000
2	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/mjet/Vit	7,000
3	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Lekë/ 5 vjet	22,000
4	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Lekë/mjel/Vit	2,000
5	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	Lekë/ 5 vjet	90,000
6	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarku	Lekë/mjet/Vit	2,000
7	Licencë për linjat qytetëse të transportit të udhëtarëve	Lekë/10 vite	80,000
8	Licencë për linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve	Lekë/10 vite	40,000

9	Licencë për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	Lekë/ 5 vjet	25,000
10	Licencë për agjenci ndërkombëtare udhëtarësh	Lekë/ 5 vjet	60,000
11	Licencë për transport udhëtarësh me taksi	Lekë/mjet/ 5vite	25,000
12	Licencë për shërbime të rregullta të specializuara të udhëtarëve	Lekë/ 5vite	20,000
13	Çertifikatë për shërbime të rregullta të specializuara të udhëtarëve	Lekë/mjet/Vit	1,500
14	Licencë për shërbime vajtje-ardhje (lavjerrës) të udhëtarëve	Lekë/ 5 vite	20,000
B	TARIFA TË LICENCIMIT TË TRANSPORTIT TË MALLRAVE		
1	Licencë për transport mallrash për të tretë dhe/ose me qira brenda vendit	Lekë/për licensë/vit	10,000
2	Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	Lekë/Kapacitet/vit	1,000
3	Çertifikatë për transport mallrash për vete brenda vendit	Lekë/Kapacitet/vit	1,000
C	AUTORIZIME KARBURANTI/LËNDË DJEGËSE/BOMBULA GAZI		
1	Licencë karburanti / lëndë djegëse	5 vjet ose Rinovimi	1,000,000
2	Autorizim për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombulave të gazit	5 vjet ose Rinovimi	100,000
D	VEPRIMTARI TË TJERA		
1	-Libri i udhëtimit për shërbimet e rastit të udhëtarëve brenda vendit,	libër	2,000

Kujdes

- Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie, paguhet **30%** e vlerës së plotë të tarifës,
- Për rastet e ndryshimeve në licenca/çertifikata që lidhen me elementë të përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj., paguhet **30%** e vlerës së plotë,
- Licencat model 109 për transport malli për të tretë me qira do të jepen **njëvjeçare**,
- Tarifa e shërbimit për licencë, çertifikatë ose autorizim në fushën e transportit është **1,000 lekë**,

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj tarife

- ☐ Çertifikatat përpilohen nga **Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Transportit Publik, Sistemit të Adresave dhe Sinjalistikës Rrugore**,
- ☐ Tarifat e licencave llogariten dhe arkëtohen nga **Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave**,

V. TARIFA PËR DHËNIE LEJE USHTRIM AKTIVITETI

- Objekt janë ato aktivitete për të cilat Bashkia jep leje për zhvillimin e tyre në hapësirat publike, si:

cirk, panairë, spektakle, reklamime etj, → Tarifa: 5,000 Lekë / m² / ditë

- b) Tarifa për përdorim të ambienteve sportive dhe kulturore(palestra, kalçeto, fusha të hapura në shkolla, kinoteatër, salla mbledhjesh etj,) — sipas përcaktimeve të Bashkisë.

Tabela 13- Tarifat për përdorim të terreneve sportive dhe ambienteve publike

Nr,	Emërtimi	Niveli i Tarifës
1	Tarifë për zhvillim të aktiviteteve në terrenet sportive	
a	Në terrene sportive të hapura	10,000 Lekë/muaj
b	Në terrene sportive të mbyllura	20,000 Lekë/muaj
2	Tarifë për çdo aktivitet që do të zhvillohet në pallatin e sportit, kinoteatër ose sallë mbledhjesh, etj, (Përfshijë aktivitetet e organizuara nga Bashkia)	50,000 Lekë/ditë

c. Tarifë për vendosjen e lodrave për fëmijë dhe të rinj

- Tarifa minimale: **100 Lekë / m² / muaj**
- Për këtë pikë ("c") mund të zhvillohet një **procedurë e hapur konkurimi**, ku, ndër të tjera, merret në konsideratë edhe oferta më e mirë ekonomike, por në çdo rast jo më pak se tarifa e sipërpërmendur,

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj tarife

- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Transportit Publik, Sistemit të Adresave dhe Sinjalistikës Rrugore** ngarkohet me dhënien e lejeve përkatëse sipas llojit të aktivitetit,
- Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave** është përgjegjëse për llogaritjen dhe arkëtimin e tarifës,
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Transportit Publik, Sistemit të Adresave dhe Sinjalistikës Rrugore**, në bashkëpunim me **Policinë Bashkiake**, janë strukturat përgjegjëse për zbatimin e penaliteteve në rast mospajisjeje ose moszbatimi të lejeve përkatëse.

VI. TARIFA PËR SHËRBIME ADMINISTRATIVE DHE URBANISTIKE

Tabela 14- Tarifa Për Shërbime Administrative

Nr,	Kategoritë	Vlera e Tarifës
1	Për shërbimin arkivor tërheqjeje dokumentesh, njësimet me origjinalin dhe vërtetime	10 Lekë/flet
2	Për shërbime nga të gjitha Drejtoritë dhe zyrat e Bashkisë (lëshim vërtetimesh, dublikatë dokumenti, etj,)	200 Lekë/flet
3	PËR SHËRBIME NË RAJONE DHE NJËSITË ADMINISTRATIVE:	
	a) Vërtetim për hipotekim të pasurisë së paluajtshme	200 Lekë
	b) Të gjitha vërtetimet e tjera	200 Lekë

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj tarife

- Faturimi dhe arkëtimi bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave, pas konfirmimit nga Drejtoria përkatëse që kryen shërbimin

Tabela 15- Tarifat e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Transportit Publik, Sistemit të Adresave dhe Sinjalistikës Rrugore

Nr,	Emërtimi	Niveli i tarifës (në Lekë)
1	Tarifë Aplikimi për leje punimesh për:	
	a) Individ	5,000
	b) Person juridik	10,000
	1, Tarifë aplikimi për leje zhvillimi	15,000
	2, Tarifë për shtyrje afati leje ndërtimi	20,000
	3, Aplikim për çertifikatë përdorimi	25,000
	4, Tarifë për ndryshim projekti	10,000
	5, Tarifë aplikimi për leje ndërtimi deri në 250 m ²	15,000
	6, Tarifë aplikimi për leje ndërtimi mbi 250 m ²	25,000
2	7, Tarifë aplikimi për deklaratë paraprake punimesh	10,000
	Tarifa për Aktkontrollat	
	1, Kontroll i piketimit të objektit deri në 3 kate	3,000
	2, Kontroll i piketimit të objektit mbi 3 kat	6,000
	3, Kontroll i përfundimit të themeleve	3,000
	4, Kontroll i përfundimit të karabinasë deri në 3 kate	6,000
	5, Kontroll i përfundimit të karabinasë mbi 3 kate	9,000
	6, Kontroll i përfundimit të objektit	12,000
	7, Kontrolli i sistemimit të objektit	5,000
3	Tarifa për fotokopjime të planshetave	
	1, Format A4	200
	2, Format A3	300
	3, Format A2	400
	4, Format A1	600
	5, Format A0	1,000
	6, Fotokopje dokumentacioni të arkivit (për fletë)	300
4	Tarifa për dhënie plani gjeneral (Gentplan) të paazhornuar	
	a) Format A4	1,500
	b) Format A3	5,000
5	Tarifa për fotokopje të dokumentacionit të dosjes me njësim me origjinalin (Kërkesa e organeve të drejtësisë)	5,000
6	Përgatitja dhe përcjellja e dokumentacionit të fitimit të pronësisë (për në ZVRPP Fier)	2,000

7	Kërkesë e përsëritur për dokumentacion teknik-ligjor të dosjeve të lejeve të ndërtimit(për në ZVRPP)	2,000
8	Tarifa për deklarata (vetëdeklarim) për kryerje punimesh	
	1, Për persona fizik	2,000
	2, Për persona juridik	5,000
9	Leje për ndërhyrje të ndryshme	
	1, Leje për prerje peme	1,000
	2, Leje për hapje kanali në rrugë	3,000

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj tarife

Faturimi dhe arkëtimi bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave, pas konfirmimit nga Drejtoria përkatëse që kryen shërbimin,

VII. TARIFA E ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE

Tabela 16-Tarifa e zënies së hapësirës publike

Kategoria	Niveli i tarifës për Bashkinë	Niveli i tarifës për Njësitë Administrative
Zënie e hapësirës publike (Janr - Dhjetor)	400 Lekë/m ² /muaj	100 Lekë/m ² /muaj

Kjo tarifë paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi, Tarifa llogaritet si detyrim vjetor i tatimpaguesit, në bazë të sipërfaqes së zënë dhe periudhës së përdorimit,,

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj tarife

- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Transportit Publik, Sistemit të Adresave dhe Sinjalistikës Rrugore ngarkohet me ndjekjen, matjen dhe kontrollin e territorit për sipërfaqet që shfrytëzohen nga bizneset, si dhe me përgatitjen e Lejes së Shfrytëzimit të Hapësirës Publike,
- Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave ngarkohet me faturimin dhe verifikimet në terren të hapësirës publike, pas miratimit të Lejes përkatëse,
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Transportit Publik, Sistemit të Adresave dhe Sinjalistikës Rrugore, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, janë strukturat përgjegjëse për penalitetet në rast mospajisjeje ose moszbatimi të lejeve të kërkuara.

VIII. TARIFA TË NDRYSHME NË FUNKSION TË DREJTORIVE DHE NDËRMARRJEVE VARTËSE.

Tabela 17- Tarifa për tregjet e miratuara

1	Tarifa për tregun e organizuar në rrugë në Njësitë Administrative	200 Lekë/ditë/post
2	Tarifa për tregtim në tregun ditor	300 Lekë/ditë/post
3	Tarifa mujore për tregtim në tregun ditor	5,000 Lekë/muaj/post

4	Tarifa për tregëtim në tregun e tregtarëve me shumicë	400 Lekë/ditë/post
5	Tarifa mujore për tregëtim të tregtarëve me shumicë	10,000 Lekë/muaj/post

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj tarife

Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave është përgjegjëse për faturimin dhe arkëtimin e këtyre tarifave,

Tabela 18- Tarifa e shfrytëzimit të plazheve

Nr,	Emërtimi	Niveli i tarifës për një sezon turistik
1	Tarifa për shfrytëzimin e plazheve	100 Lekë/m ²

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj tarife

- Njësitë Administrative ngarkohen me verifikimin dhe kontrollin në terren të sipërfaqeve të zëna,
- Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave është përgjegjëse për faturimin dhe arkëtimin e tarifave,

Tabela 19- Tarifë për kalimin e linjave tokësore dhe ajrore

NR,	EMËRTIMI	Niveli Tarifes për vit
1	Tarifë për shfrytëzimin e tubove të linjave tokësore	1,000 Lekë/km
2	Tarifë për shfrytëzimin ajror të linjave	5,000 Lekë/km
3	Tarifë për shfrytëzimin ajror/nëntokësor të linjave elektrike të infrastrukturës për panele fotovoltaike	10,000 Lekë/km

Struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe arkëtimin e kësaj tarife

- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Transportit Publik, Sistemit të Adresave dhe Sinjalistikës Rrugore ngarkohet me evidentimin e linjave,
- Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Pronave Publike, si dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, janë përgjegjëse për llogaritjen e detyrimeve,
- Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave ngarkohet me faturimin dhe arkëtimin e tarifave

IX. TARIFA TË DHËNIES ME QIRA

Tabela 20/a: Tarifa për dhënie me qira objektsh dhe trualli

Nr,	Emërtimi	Qytet	Njësi Administrative
		Niveli i Tarifës	
1	Tarifa për dhënien me qira objekti	400 Lekë/ m ² /muaj	200 Lekë/m ² /muaj
2	Tarifa për dhënien me qira trualli	200 Lekë/ m ² /muaj	50 Lekë/ m ² /muaj
4	Tarifa për dhënie me qira tok pa frut	27,000 Lekë/ha/vit	27,000 Lekë/ha/vit

Tabela 20/b: Tarifë për dhënie me qira tokë bujqësore:

Kategoria e tokës sipas bonitetit	I	II	III	IV	V	VI-VII	VIII-X
Vlerë minimale Lekë/ha /vit	17,000	15,000	12,000	10,000	7,000	5,000	6,000

Shënim: Vlerat e përcaktuara në Tabelën 19/b mund të jenë të ndryshueshme në bazë të kërkesës së subjekteve apo individëve gjatë procedurës së konkurimit, por në asnjë rast nuk mund të jenë më të ulëta se vlerat e përcaktuara më sipër,

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj tarife

- Drejtoria e Menaxhimit të Pronave ngarkohet me ndjekjen e procedurave për dhënien me qira të pasurive publike,
- Drejtoria e Përgjithshme e të Ardhurave është përgjegjëse për faturimin dhe arkëtimin e këtyre tarifave,
- Tarifatat për dhënien me qira të kullotave janë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr, 632, datë 11,06,2009, "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje,"
- Tarifatat për dhënien me qira të pyjeve janë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr, 391, datë 21,06,2006, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave," i ndryshuar me aktet pasuese,

X. TARIFË PËR SHËRBIMIN E VARRIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË VARREZAVE PUBLIKE

- Në bazë të Vendimit Nr, 50, datë 23,07,2021, të Këshillit të Bashkisë Fier, është vendosur që shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe shërbimi i varrimit të kryhen nga Bashkia Fier,
- Në këtë kuadër, është ngritur Ndërmarrja e Gjelbërimit, Mirëmbajtjes së Varrezave Publike dhe Shërbimit të Varrimit, e cila ka në ngarkim administrimin dhe ofrimin e këtyre shërbimeve për qytetarët,
- Tarifa e mëposhtme përfshin vetëm shërbimin e kryerjes së procesit të varrimit, dhe nuk përfshin tarifat e shoqërive private funerale, Shërbimi përfshin të gjitha veprimet logjistike dhe administrative të procesit të varrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave publike,

Tarifa e përlogaritur për këtë shërbim nga Bashkia Fier është:

Tablela 21- Tarifë për shërbimin e varrimit

Nr,	Lloji i shërbimit	Tarifa (në Lekë)
1	Shërbim varrimi për fëmijë	10,000 Lekë / shërbim
2	Shërbim varrimi për të rritur	18,000 Lekë / shërbim
3	Zhvarrim	7,000 Lekë / shërbim
4	Prenotim varri	20,000 Lekë/shërbim

XI. TARIFA E PARKIMIT NË PARKIMIN NËNTOKËSOR DHE NË TERMINALIN E AUTOBUSËVE (TEK ISH STACIONI I TRENIT)

Ky kapitull përcakton tarifat e përdorimit të hapësirave (publike), të parkimit nëntokësor dhe të parkimit pranë terminalit të autobusëve, në zonën e stacionit të trenit, gjatë orarit të përcaktuar për shërbimin publik të parkimit,

Tablela 22- Tarifa e parkimit në parkimin nëntokësor dhe në terminalin e autobusëve (tek ish stacioni i trenit)

Nr	Orë qëndrimi parkim	Vlera e tarifës
1	Tarifat e parkimit për parkimin nëntokësor për kohëzgjatjen nga ora 08,00-22,00	
a	0-10 min	0 Lekë
b	11 min-2 orë	100 Lekë
c	2-4 orë	300 Lekë
d	mbi 4 orë	500 Lekë
2	Tarifat e parkimit pranë Stacionit të Trenit për kohëzgjatjen nga ora 08,00-22,00	

a	0-10 min (Përjashto kategorinë Furgona Autobuza, Mikrobuza	0 Lekë
b	11 min -1 orë	50 Lekë
c	1-2 orë	100 Lekë
d	2-4 orë	300 Lekë
e	Mbi 4 orë	500 Lekë
f	Qëndrim nga ora 22,00-08,00	100Lekë
g	Hyrja në parkim për furgonë	200 lekë
h	Hyrje në parkim për autobusë dhe mikrobusë	300 lekë

Në rast të mosfunksionimit të sistemit për shkaqe objektive tarifa do të aplikohet manualisht nga punonjësit e parkimit

- Të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak që hien në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohen,
- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat e ngarkuara për arkëtimin dhe faturimin e taksave dhe tarifave vendore të miraluar më sipër.
- Ky vendim hyn në fuqi datë 01.01.2026

KRYETAR I KËSHILLIT
ANTONETA CUNAJ

